

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA GRAMSH

RELACION TEKNIK

**Objekti: Sistemim – Asfaltim lagjia “Dellinje”**

**Të përgjithshme**

Ky objekt përfshin sistemimin dhe asfaltimin e rrugeve të brendshme të zonës të Lagjes “Dellinje” si dhe ndricimin në brendësi të lagjes. Së bashku me asfaltimin e rrugeve të brendshme, do të realizohet edhe punimet e trotuarëve, sistemimi i ujrave të bardha në kanalizimet përkatëse. Gjatësia e rrugës së asfaltuar të parashikuar në projekt është 280 m dhe sipërfaqja e nje pjese te rruges me beton 300 m<sup>2</sup>.

**Gjendja aktuale**

Aktualisht, kjo zonë ndodhet në kushte të vështira për sa i përket infrastrukturës së rrugës, në mungesë të plotë të ndriçimit adekuat dhe trotuarëve, si dhe ujrave sipërfaqësore janë të pa sistemuara, konkretisht në rastet e reshjeve kjo zonë bëhet e pakalueshme nga ana e banorëve rezidentë. Për këto arsye, këta banorë kanë kërkuar sistemimin dhe asfaltimin e kësaj lagjeje.

**Vizioni**

Bashkia Gramsh ka hartuar projektin dhe kërkon ta implementojë atë duke synuar shndërrimin e kësaj zone të pa urbanizuar në një mjedis të përshtatshëm urban, të pajisur me gjithë infrastrukturën e duhur sa më afër nevojave të komunitetit, duke shmangur fenomenet e padëshirueshme si psh përmytjet.

**Përshkrimi i punimeve**

Në këtë projekt janë përfshirë punimet e ndërtimit të rrugëve, trotuarëve, ndriçimit të rrugës, kanalizime të ujrave të bardha, parkime dhe lulishte.

1. Punime prishje parashikon prishje të rrethimeve të qytetarëve në hapësira publike dhe transportimin e tyre në vendin e përcaktuar për mbetjet inerte.
2. Punime në rrugë që përfshin gjurmimin e trasesë së rrugës, punime të shtresave të domosdoshme si zhavorr, cakull, stabilizant, bitum dhe asfalto/beton.
3. Punime për kanalizimet e ujrave të bardha në të cilat përfshihen gjurmimet për kunetat, pusetat ujëmbledhëse, vendosja e tubave, puseta kontrolli, shtresat e reres, mbushje me dhë dhe betonim të kunetave.

4. Punime për vendparkimimin e automjeteve në të cilën përfshihen punimet e gërmimeve në seksion dhe të lirë dhe për themele, F.V të borduravë të betonit, betonim të themeleve të tyre, punime shtresash e struktura të betonit.
5. Punime të ndriçimit në të cilën përfshihen punime për gërmimin, vendosje të tubave dhe përcjellësve, vendosja e shtyllave së bashku me ndriçuesit LED, pusetave plastike dhe F.V kuadër komandimi komplet me santeri + fotoelement.

HARTOI

Ing. Ali Çohodari

